



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 dhjetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për t'iu Kundërpërgjigjur Parashtrimin F01962

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 76 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 7 nëntor 2023, me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"),¹ Trupi Gjykses pranoi si prova materiale dy deklarata të W03825-ës sipas rregullës 143(2).² Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") nuk e kundërshtoi pranimin e tyre, por vuri në dukje kundërshtimin e saj në vijimësi për përdorimin, si prova materiale, të pjesëve të deklaratës së mëparshme të dëshmitarit të pranuar sipas rregullës 143(2), të cilat nuk iu treguan dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje.³

2. Më 9 nëntor 2023, Trupi Gjykses ftoi Mbrojtjen e Thaçit që të konfirmonte me shkrim kundërshtimin e saj lidhur me deklaratat e pranuar sipas rregullës 143(2).⁴ Trupi Gjykses u shpreh gjithashtu se nuk kishte nevojë për kundërpërgjigje.⁵

3. Më 20 nëntor 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi parashtrime me shkrim lidhur me përdorimin e deklaratave të mëparshme mospërputhëse të pranuar sipas rregullës 143(2)(c) ("Parashtrimet e Thaçit").⁶

4. Më 27 nëntor 2023, ZPS-ja iu përgjigj parashtrimeve të Thaçit ("Përgjigje").⁷

¹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, p. 9509, rreshti 24 deri në f. 9510, rreshti 16.

² Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, p. 9511, rreshti 21 deri në f. 9512, rreshti 1.

³ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, p. 9510, rreshti 19 deri në f. 9511, rreshti 5.

⁴ Transkripti i seancës, 9 nëntor 2023, p. 9705, rreshti 24 deri në f. 9706, rreshti 1.

⁵ Transkripti i seancës, 9 nëntor 2023, p. 9706, rreshti 6.

⁶ F01940, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përdorimin e Deklaratave të Mëparshme Mospërputhëse sipas Rregullës 143(2)(c)*, 20 nëntor 2023.

⁷ F01962, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit mbi Rregullën 143(2)(c)*, 27 nëntor 2023.

5. Më 28 nëntor 2023, Mbrojtjen e Thaçit dorëzoi një kërkesë për leje për t'iu kundërpërgjigjur Përgjigjes ("Kërkesa").⁸ Mbrojtja e Thaçit parashtron se është e nevojshme të jepet kundërpërgjigje për shkak të rëndësisë dhe risisë së kësaj çështjeje dhe ndikimit të saj të mundshëm në dëshmitë e mëvonshme dhe drejtësinë e gjykimit.⁹ Mbrojtja e Thaçit deklaroi se do ta kufizojë kundërpërgjigjen e vet në 500 fjalë dhe në paragrafin 7 të Përgjigjes për të sjellë në vëmendje të Trupit Gjykses precedentët ligjorë.¹⁰

6. Më 30 nëntor 2023, ZPS-ja informoi Trupin Gjykses se nuk do t'i përgjigjet Kërkesës.¹¹

II. DISKUTIM

7. Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Thaçit ka dhënë arsye të mjaftueshme për të përligjur kundërpërgjigjen e saj ndaj Përgjigjes, duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes dhe ndikimin e mundshëm të përdorimit të deklaratave të rregullës 143(2)(c) mbi palët.

8. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses e miraton Kërkesën dhe urdhëron Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë kundërpërgjigje përmbajtja e së cilës të kufizohet në trajtimin e paragrafit 7 të Përgjigjes dhe që nuk i kalon 500 fjalë, në përputhje me afatin e përcaktuar në rregullën 76.

⁸ F01967, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçi për Leje për t'iu Kundërpërgjigjur Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Parashtrimeve të Mbrojtjes së Thaçit për rregullën 143(2)(c)*, 28 nëntor 2023.

⁹ Kërkesa, para. 2.

¹⁰ Kërkesa, para. 3.

¹¹ CRSPD379, *Mesazh elektronik nga ZPS-ja drejtuar NJAGJ-së*, 30 nëntor 2023.

III. VENDIM

9. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë kundërpërgjigje ndaj paragrafit 7 të Përgjigjes, e cila nuk duhet të tejkalojë 500 fjalë, në përputhje me afatin e përcaktuar në rregullën 76.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E premte, 1 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.